



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.911/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në kontestin tregtar-administrativ të paditësit-propozuesit “B.K.H.” B.I, me numër unik identifikues 811307695 me seli në Malësia e Re-Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.Z.S. avokate nga Prishtina, kundër të paditurës-kundërpropozuesit Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit-propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.142/24, të datës 21.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit “B.K.H.” B.I, me seli në Prizren, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.142/24, të datës 21.03.2024 VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, me Aktvendimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: REFUZOHET propozimi-kërkesa e “B.K.H.” B.I, me seli në Prizren përmes të cilës ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ

përfundimtar - vendimit me nr.prot. 22/2024 të datës 03.02.2024, të të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.

Procedura sipas padisë në këtë konflikt administrativ do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës në kontestin tregtar-administrativ dhe sipas planit të punës së Gjykatës.

Kundër këtij Aktvendimi, ka ushtruar ankesë paditëseja, me të cilën e ka kundërshtuar Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkëlqes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovon si të bazuar ankesën e paditëses.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se nuk ka gjetur asnjë provë të vetme, me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast. Propozuesi në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit, nuk ka dëshmuar se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, se ekziston rreziku i shkakut të dëmit apo humbjeve të tjera, nëse nuk caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit kontestues.

Gjykata në shkallë të parë duke vlerësuar propozimin - kërkesën e paditësit dhe shkresat e lëndës e të cilat në tërësi u referohen vetëm pretendimeve të padisë ka konstatuar se propozuesi i masës nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë konkrete se ekzekutimi i vendimit kontestues, do të mund të shkaktohej ndonjë dëm të riparueshëm, e i cili do të mund të riparohet me vështirësi, ashtu siç është përcaktuar me nenin 22, paragrafi 6, e lidhur me paragrafin 2, të këtij neni, të LKA-së. Prandaj, gjykata vlerëson se propozimi - kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit të të paditurës nr.prot. 22/2024 të datës 03.02.2024, është e pa bazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do të sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do të sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Në rastin konkret propozuesi-paditësi me padi ka hap konfliktin administrativ për shkak të anulimit të vendimit të paditurës, nr.prot. 22/2024 të datës 03.02.2024, dhe ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, me të cilin vendim e paditura ka vendosur refuzohet kërkesa e subjektit në procedurë, pra paditësi ka kërkuar që i njëjti vendim të shtyhet deri në përfundimin e procedurës sipas padisë, me arsyetim se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar propozuesit, do t'i sillte dëm të konsiderueshëm dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk i shkakton dëm palës kundërshtare dhe personave të interesuar.

Edhe kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë njëjtë si gjykata e shkallës së parë vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit paditësit nuk do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Pretendimet ankimore të palës paditëse, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka

kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.

Meqë në këtë rast paditësja në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e saj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE KOSOVËS**

### **Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.911/24, data 25.04.2024**

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti, d.v